

Mirë për ta ditur

[Orari i punës / ditët e festave](#)

[Lejeqëndrimi](#)

[Sigurimi i përgjegjësisë private](#)

[Alkooli / duhani / droga](#)

[Shtazët shtëpiake](#)

[Kështu frymon Zvicra](#)

Orari i punës / ditët e festave

Në Zvicër shumica e shitoreve, janë të mbyllura të dielën. Përjashtim bëjnë shitoret në stacionet e trenit. Ditët festive janë të rregulluara me ligjet e kantonit

Ditët e festave

Ditët e festave rregullohen nga ligji i punës dhe ligjërisht janë të barazvlefshme me të dielat. 1 gushti (Festa Kombëtare) është një ditë zyrtare pushimi në të gjithë Zvicrën. Përveç kësaj, çdo kanton mund të caktojë edhe festa zyrtare të tjera.

- Dita e Vitit të Ri
- E Premtja e Madhe
- E Hëna e Pashkëve
- Ngjitja e Krishtit
- E Hëna e Rrëshajave
- Festa Kombëtare e Zvicrës
- Dita e Krishtlindjes
- Dita e Shën Stefanit (Dita e Shën Stefanit nuk festohet nëse dita e Krishtlindjes bie në një të hënë ose të premte.)

Orari i punës së shitoreve

Appenzell Ausserrhoden: Bli më gjatë vetëm në Herisau

Në Kantonin Appenzell Ausserrhoden, komunat përcaktojnë oraret e mundshme të zgjatura të hapjes së dyqaneve. Kjo është futur deri tani vetëm në qytetin kryesor Herisau. Atje, dyqanet e mëdha Migros dhe Coop mbajnë dyqanet e tyre të hapura më gjatë. Migros është e hapur çdo ditë nga ora 7 deri në ora 20, të shtunën nga ora 7 deri në ora 18. Coop merr pjesë në shitjet e mbrëmjes të premteve.

Ndërmarrjet më të vogla zakonisht mbyllen në ora 18:30. Të dielave, dyqanet duhet të mbesin të mbyllura në parim, përveçse për një maksimum prej katër shitjeve të dielave në vit.

Megjithatë, komunat mund të japin leje për përjashtime për shitjet e dielave, nëse "rrethanat e justifikojnë". Këto kritere mund të përfshijnë, për shembull, dyqanet e luleve, dyqanet e pompave të benzinës, furrat e bukës ose kiosqet, thotë Kantonin në kërkesë.

Oraret e punës së administratës publike

Administrata kantonale sipas rregullit prej të hënes deri të premtën nga ora 7.30 deri në orën 12.00 dhe nga ora 13.30 deri në 17.00 është e hapur. Orari i punës në administratat komunale është shumë i ndryshëm. Para së gjithash në komunat e vogla, orari i punës mund të jetë i kufizuar. Është e këshillueshme që në çdo rast, paraprakisht përmes internetit apo telefonit të njoftoheni se kur janë të hapura sportelet.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-ar.ch/sq/mire-per-ta-ditur/orari-i-punes-ditet-e-festave

Lejeqëndrimi

Për të banuar ose për të punuar më gjatë në Zvicër duhet pasur leje. Mes lejeve të ndryshme të qëndrimit dhe lejes së vendosjes ka dallim.

Llojet e lejeve

Kush në Zvicër punon apo qëndron më shumë se tre muaj, i duhet një lejeqëndrim. Ky ipet prej zyrës për Migrim dhe Integrim (Amt für Migration und Integration). Ka dallim mes lejeve të qëndrimit, lejeqëndrimi afatshkurtër (deri 1 vit), lejeqëndrimi (i kufizuar) dhe lejeqëndrimi (i pakufizuar).

- Lejeqëndrimi afatshkurtër (L): Ky lejeqëndrim është për personat, të cilët për një kohë të kufizuar (më së shumti një vit) për një arsye të caktuar jetojnë në Zvicër. Shumica e qytetarëve të vendeve të BE-së/EFTA-s, të cilët mund të ofrojnë dëshmi për marrëdhënie pune nga 3 muaj deri në një vit (një kontratë pune) kanë të drejtë në këtë leje.
- Lejeqëndrimi (B): Kjo leje është për personat që qëndrojnë në Zvicër për një periudhë më të gjatë kohore. Shumica e qytetarëve të vendeve të BE/EFTA kanë të drejtë për këtë nëse mund të dëshmojnë se kanë punuar në Zvicër më shumë se një vit (kontrata e punës). Leja u jepet qytetarëve të BE/EFTA për 5 vjet. Për njerëzit nga vendet tjera, periudha e vlefshmërisë është 1 vit. Pas kësaj, duhet të aplikohet për vazhdimin e lejeqëndrimit. Vazhdimi për këta persona kushtëzohet, p.sh. me ndjekjen e një kursi të gjermanishtes. Nuk kanë të drejtë për zgjatje. Arsyet që mund të flasin kundër një zgjatjeje janë, për shembull, veprat penale ose varësia nga ndihmat sociale. Gjithashtu dhe refugjatët me status të njohur marrin lejeqëndrimi B.
- Lejeqëndrimi (C): Këtë lejeqëndrim e merr njeriu pas 5 apo 10 vitesh qëndrimi në Zvicër. Edhe këtu vlejné kushte të ndryshme për personat nga vendet e BE/EFTA dhe vendet e treta.
- Pranime të përkohshme (F): Këtë lejeqëndrim e marrin azilkërkuesit, të cilët nuk pranohen si refugjatë, mirëpo merren përkohësisht. Lejeqëndrimi duhet të vazhdohet çdo vit.

Letërnjoftimi për të huaj

Të huajat dhe të huajt, që banojnë në Zvicër, e marrin letërnjoftimin për të huaj. Lloji i letërnjoftimit varet nga kritere të ndryshme. Ka letërnjoftim në formatin e kartelës së kredisë dhe letërnjoftime nga letra (letërnjoftim jo biometrik për të huaj, nicht biometrischer Ausländerausweis). Disa persona e marrin letërnjoftimin biometrik për të huaj. Ky letërnjoftim e ka një çip me të dhëna, ku janë shenjat e gishtërinjëve dhe fotografia. Ata duhet që të dhënat e tyre biometrike t'i kenë të regjistruara në Hersiau. Për ta bërë këtë, duhet bërë vetë një termin në Qendrën Përmbledhëse Biometrike (Herisau). Dëshmia do të dërgohet në shtëpi me postë të regjistruar pasi të përfundojë. Nëse ua vjedhin letërnjoftimin apo humbet, duhet menjëherë ta njoftoni policinë.

Vazhdimi

Varësisht nga lloji i statusit të qëndrimit dhe përkatësisë shtetërore, lejeqëndrimi duhet të vazhdohet në intervale të ndryshme. Nëse vazhdimi është i nevojshëm, duhet marrë një formular njoftim skadimi (Verfallsanzeige). Ky duhet të plotësohet dhe së bashku me një pasaportë udhëtimi të vlefshme, më së voni dy javë para kalimit të lejeqëndrimit duhet të dorëzohet në komunën përkatëse ku banoni. Komuna e dërgon kërkesën tutje në zyrën për Migrim dhe Integrim të kantonit (Amt für Migration und Integration). Kjo vërteton, nëse janë përmbushur parakushtet për vazhdim. Nëse keni pyetje, ju përgjigjet komuna përkatëse ose Enti për Migrim dhe Integrim.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-ar.ch/sq/mire-per-ta-ditur/lejeqendrimi

Sigurimi i përgjegjësisë private

Çdo person i rritur duhet ta bëjë një sigurim privat të përgjegjësisë personale. Ky i merr përsipër shpenzimet, nëse dikujt padashje i shkaktohet dëm.

Përgjegjësia personale

Nëse lëndoni një person tjetër ose dëmtoni një send që i përket dikujt tjetër, ju jeni financiarisht përgjegjës. Kjo vlenë edhe nëse dëmi nuk është shkaktuar me dashje. Kostot mund të jenë shumë të larta. Për shembull, nëse lëndoni dikë gjatë skijimit, dëmi mund të arrijë në qindra mijëra franga.

Sigurimi i përgjegjësisë private

Për të mos hyrë në vështirësi financiare nëse ndodhë një dëm, nevojitet një sigurim i përgjegjësisë private (Privathaftpflichtversicherung). Ky sigurim ofrohet prej shumicës të sigurimeve private. Sigurimet private të përgjegjësisë personale shpesh mund të bëhen për të gjithë personat që jetojnë bashkë. Sigurimi nuk është i obligueshëm por patjetër sugjerohet. Shumë pronarë kërkojnë gjithashtu një sigurim përgjegjësie.

Shërbimet e sigurimit

Sigurimi i përgjegjësisë personale mbulon dëmtimet pronësore dhe dëmtimet personale të shkaktuara nga një i siguruar te tjetri. Ky përfshin, për shembull, kostot e riparimit, shpenzimet mjekësore, kompensimin për humbjen e pagave ose kompensimin për dhimbjen. Sigurimi i përgjegjësisë personale mbulon gjithashtu dëmet e shkaktuara nga disa kafshë shtëpiake. Ky sigurim nuk zhdëmton nëse u shkaktoni dëm njerëzve që jetojnë në të njëjtën familje. Dëmi i shkaktuar me dashje ose nga pakujdesia e rëndë gjithashtu nuk mbulohet.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-ar.ch/sq/mire-per-ta-ditur/sigurimi-i-pergjegjesise-private

Alkooli / duhani / droga

Kushdo që mbanë, konsumon apo shet drogë, bënë vepër penale. Për shitjen e alkoolit dhe duhanit ka kufinjë moshe.

Drogat

Mbajtja, shitja apo konsumimi i drogave ilegale është vepër penale. Kjo vlenë edhe për sasi të vogla. Cilat substanca janë ilegale, është e rregulluar me ligjin për substancat narkotike (Betäubungsmittelgesetz). Shitja e drogave në mënyrë biznesore ndëshkohet me gjoka të larta.

Alkooli dhe duhani

Për shitjen e alkoolit dhe duhanit ka kufizim të moshës. Kështu në kantonin Appenzell Ausserrhoden duhani dhe pijet alkoolike nuk guxojnë tu shiten fëmijëve dhe të rinjve nën moshën 16 vjeçare. Për pije alkoolike të veçanta si spirituozet, kufiri qëndron te mosha 18 vjeçare.

Ndalimi i pirjes të duhanit

Ndalimi i pirjes të duhanit në Zvicër dallon nga kantoni në kanton. Kantoni i Appenzell Ausserrhoden mbështetet në ligjin federal për mbrojtjen e duhanpirësve pasiv dhe nuk njih ligj tjetër të dhënë prej kantonit.

Ndalim i pirjes të duhanit vlen në:

- Në hapësirat e mbyllura që janë të aksesueshme për publikun, veçanërisht në ndërtesat e administratave publike, spitale, azile, institucione arsimore, kulturore dhe sportive dhe në të gjitha fushat e gastronomisë, ndalohet pirja e duhanit.
- Mund të ofrohen hapësira të ndara dhe të markuara si të tilla me ventilim të mjaftueshëm për ata që duan të pinë duhan.
- Përrjashtimet rregullohen nga qeveria kantonale.

Pirja e duhanit është gjithashtu e ndaluar në ambientet e brendshme të restoranteve. Një përjashtim janë dhomat e duhanpirësve, që janë të ndara dhe të ventiluara, por ato po bëhen gjithnjë e më të pakta. Ndaletat e pirjes së duhanit kanë për qëllim mbrojtjen e shëndetit të njerëzve.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-ar.ch/sq/mire-per-ta-ditur/alkooli-duhani-droga

Shtazët shtëpiake

Kushdo që mbanë shtazë shtëpiake, duhet tu përmbahet rregullave të ndryshme. Kështu, disa lloje shtazësh nuk mund të mbahen në çdo banesë. Mbajtëset dhe mbajtësit e qenve duhet të paguajnë taksa për qenë.

Të mbashë shtazë shtëpiake

Kush jeton në një banesë me qira, në çdo rast guxon të mbajë kafshë të vogla, si derra deti, kastorë, kanarina apo peshq. Por, mbajtja e kafshëve më të mëdha (përfshirë macet apo qentë e vegjël) mund të jetë e ndaluar në kontratën e qerasë. Edhe kafshët që shkaktojnë zhurmë apo janë të rrezikshme, qiradhënësit mund t'i ndalojnë. Përveç kësaj duhet që mbajtëset dhe mbajtësit e kafshëve ta respektojnë ligjin për mbrojtjen e kafshëve. Për shembull, disa kafshë të veçanta nuk guxon t'i mbaj vetëm (p.sh. lepujt). Ka gjithashtu rregulla për madhësinë dhe paisjen e kafazit. Shumë shtazë (shtazë ekzotike) nuk guxojnë fare të sillen në Zvicër. Për disa të tjera nevojitet një leje speciale nga Enti i Veterinarisë.

Qentë

Në kantonin e Appenzell Ausserrhoden është një ligj special për qentë. Ai përcakton detyrimet e pronarëve të qenve. Më shumë informacione mund të jep mjeku apo mjekja e shtazëve.

- Të gjithë qentë në Zvicër duhet të shënohen me një mikroçip dhe të jenë të regjistruar në një bazë të dhënash. Qeni ka një letërnjoftim për qenë (format i kartës për kredi). Ky nuk është identik me letërnjoftimin për shtazët shtëpiake, i cili nevojitet nëse dëshirohet të udhëtohet me shtazë në vendet e Bashkimit Evropian.
- Qentë duhet të jenë të lajmëruar në komunën e vendbanimit. Për secilin qenë duhet paguar një taksë vjetore.
- Të gjithë mbajtësit e qenve duhet ta marrin dhe të përkujdesen për jashtëqitjen e qenit të tyre. Kush nuk e bënë këtë, mund të gjobitet.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-ar.ch/sq/mire-per-ta-ditur/shtazet-shtepiake

Kështu frymon Zvicra

Çdo vend i ka veçoritë e veta kulturore. Në Zvicër janë edhe disa ligje të pashkruara që duhen respektuar.

Kultura të ndryshme

Zvicra është një vend i larmishëm kulturor. Sidomos për shkak të katër grupeve gjuhësore. Pra, nuk është për t'u habitur që mentalitetet ndryshojnë shumë nga rajoni në rajon. Veçoritë kulturore të Zvicrës gjermanfolëse nuk duhet domosdoshmërisht të vlejnë edhe për Zvicrën frëngjishtfolëse. Dallimet midis rajoneve urbane dhe rurale mund të jenë gjithashtu të mëdha. Megjithatë, ka disa ngjashmëri të pakta.

Përsëndetjet

Në Zvicër njerëzit përsëndeten me dor dhe shikohen në sy si gratë, edhe burrat. Përsëndetja formale është "Grüezi" (mes shokësh ka forma tjera të përsëndetjes, si "Hallo" ose "Hoi"). Në zonat rurale, njerëzit përsëndeten në rrugë edhe kur nuk e njohin njëri tjetrin. Të rëndësishme janë edhe shprehjet "ju falemnderit" dhe "ju lutem" ("Danke" dhe "Bitte"): p.sh. në shitore dhe restorane është gati si një ritual, që shumëherë të thuhet "Danke" dhe "Bitte".

Përpikmëria

Përpikmëria e famshme zvicerane nuk është vetëm një klishe. Nëse njeriu vonohet më shumë se 5 minuta, duhet këtë ta lajmëroj me telefon. Përpikmëria është shumë e rëndësishme, veçanërisht në botën e punës. Nëse njeriu dëshiron të takohet me dikë, paraprakisht duhet ta caktoj një takim. Vizitat e paparalajmëruara nuk janë rregull as në sferën private.

Komunikimi indirekt

Në Zvicër, gjërat e pakëndshme shpesh thuhën në mënyrë indirekte. Shumë bashkëbisedues kritikën e shprehin vetëm në mënyrë të fshehtë ose i fshehin pas frazave boshe. Megjithatë, ata presin që kritikën të perceptohen. Nëse ende nuk flisni germanisht në mënyrë të përsosur, nuk është e thjeshtë. Nëse ndonjëri dëshiron të ruajë harmoninë, konfrontimi i drejtpërdrejtë në situata konflikti shpesh shmangët. Për shembull, mund të ndodhë që të merrni një letër nga fqinji juaj nëse atë e pengon ndonjë gjë. Nëse diçka është e paqartë, më mirë është njëherë të pyetni shumë sesa pak.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-ar.ch/sq/mire-per-ta-ditur/keshtu-frymon-zvicra